



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M Q A R K U L L U E S

Nr. 35, datë 27.11.2020

“Për dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave Shoqërisë së kursim – kreditit “FAST CREDIT ALBANIA””

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 17, të nenit 19, të nenit 21, të nenit 22, të nenit 26, pika 3, të nenit 34, pika 1, të nenit 52, pika 1, shkronja “p”, të nenit 53, pika 5, shkronja “d” të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 35, pika 4, të nenit 71 të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016 “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”, si dhe të nenit 5 dhe të nenit 6 të Udhëzimit Nr. 4188, datë 1.9.2016 “Për sigurimin e depozitave në shoqëritë e kursim-kreditit”, të nenit 7, pika 6 të Statutit të Agjencisë, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

1. Dhënien e vërtetimit për plotësimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore lidhur me sigurimin e depozitave Shoqërisë së kursim – kreditit “FAST CREDIT ALBANIA”.
2. Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm për nënshkrimin dhe dorëzimin e vërtetimit Shoqërisë së kursim-kreditit “FAST CREDIT ALBANIA”.
3. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për dërgimin e këtij vendimi pranë Autoritetit Mbikëqyrës.
4. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar